



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 272

Tiranë – E premte, 27 janar 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 955, datë 7.12.2016	Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike..... 27693
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 956, datë 7.12.2016	Për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike..... 27708
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 957, datë 7.12.2016	Për pagesën e kostos financiare të sistemit të identifikimit dhe të regjistrimit të kafshëve e fermave blegtorale nga fermerët..... 27710
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 194 , datë 30.12.2016	Për miratimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a., lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat..... 27711
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 195, datë 30.12.2016	Mbi shtyrjen e afatit të vendimit të ERE-s nr. 115, datë 7.8.2016, “Mbi përcaktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të Energjisë Elektrike deri më 30 qershor 2017”..... 27712
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 52, datë 14.12.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 15, datë 3.4.2013, “Për rinovim licence sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Berat–Kuçovë”..... 27713
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 53, datë 29.12.2016	Mbi tarifat e ujit për konsum publik për shoqërinë UK Elbasan (qytet) sh.a..... 27713

Vendim i Entit Rregullator i
Sektorit të Furnizimit me Ujë
dhe Largimit e Përpunimit të
Ujërave të Ndotura
nr. 54, datë 30.12.2016

Mbi tarifat e ujit për konsum publik për shoqërinë U Gramsh sh.a..... 27713

Vendim (*i shkurtuar*) për shpalljen të zhdukur të shtetases Vezire Nexhip
Gishti..... 27714

**VENDIM****Nr. 955, datë 7.12.2016****PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË
PROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT
DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË
NDIHMËS EKONOMIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, pikat 1 dhe 6, 20, pika 2, e 43, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. SUBJEKTET, KRITERET DHE
DOKUMENTACIONI PËR PËRFITIMIN E
NDIHMËS EKONOMIKE**

1. Ndihma ekonomike shpërndahet sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Ndihmë ekonomike përfitojnë:

- a) familjet në nevojë;
- b) jetimët të cilët nuk janë në institucione;
- c) prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;

ç) viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit të tyre;

d) viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.

3. Ndihma ekonomike, për familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme, është një pagesë që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, e cila kufizohet në kohë, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Kufizimi në kohë i ndihmës ekonomike nuk aplikohet, për:

- a) familjet, anëtarët e së cilës janë mbi moshë pune;
- b) familjet me kryefamiljare gra, me të paktën një fëmijë që ndjekin arsimin bazë.

4. Për të përfituar ndihmë ekonomike, subjektet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

4.1 Për familjet në nevojë, kryetari i familjes/ anëtari madhor, së bashku me bashkëshorten,

kur ka një të tillë, kërkojnë të aplikojnë pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore në bashkinë/njësinë administrative, ku kanë vendbanimin duke paraqitur, si më poshtë:

a) Kopjen e kartës së identitetit të aplikantëve;

b) Certifikatën e pronësisë, të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme/ vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Kadastrës, apo aktin e marrjes në pronësi ose në përdorim të tokës, për zonat ku regjistrimi i pronësisë nuk ka përfunduar ende.

4.1.1 Për rastet që janë në proces zgjidhjeje martese dhe ende nuk ka një vendim gjykatë të formës së prerë, dokumentacioni i përcaktuar në pikën 4.1, paraqitet i ndarë nga secili bashkëshort. Krahës këtij dokumentacioni paraqitet edhe vërtetimi i gjykatës që bashkëshortët janë në proces zgjidhjeje martese.

4.1.2 Për familjet në nevojë, që në përbërje të tyre kanë invalidë pune apo persona me aftësi të kufizuara që përfitojnë pagesë për aftësinë e kufizuar, krahës dokumentacionit të përcaktuar në pikën 4.1, paraqesin edhe kopjen e vërtetimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.

4.1.3 Për fëmijët e familjeve në nevojë, që ndjekin arsimin bazë, paraqesin edhe vërtetimin për ndjekjen e shkollës të lëshuar nga shkolla, i cili është i detyrueshëm për t’u dorëzuar dy herë brenda një viti shkollor, për të përfituar pagesën shtesë.

4.1.4 Për fëmijët e familjeve në nevojë që vaksinohen paraqesin edhe fotokopje nga libri i shëndetit të fëmijës për vaksinën e kryer sipas kalendarit të detyrueshëm për grup-moshat e fëmijëve, për të përfituar pagesën shtesë.

4.2 Jetimët, të cilët nuk janë në institucione, paraqesin pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore në bashkinë/njësinë administrative:

a) kopjen e kartës së identitetit;

b) kopjen e noterizuar për statusin e jetimit, sipas kërkesave të parashikuara në ligjin për statusin e jetimit, të ndryshuar.

4.3 Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë, plotësojnë dokumentacionin e përcaktuar në pikën 4.1 të këtij vendimi.



4.4 Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit të tyre, paraqesin:

- a) kopjen e kartës së identitetit;
- b) vërtetimin e trajtimit në institucionet e përkujdesjes shoqërore, të lëshuar brenda 30 ditëve të fundit.

4.5. Viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes paraqesin:

- a) kopjen e kartës së identitetit;
- b) urdhrin e mbrojtjes ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, për rastet e parashikuara në shkronjën “d”, të pikës 2, të këtij vendimi.

II. PROCEDURA E APLIKIMIT PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE

1. Administratori shoqëror, në prani të kryetarit të familjes/anëtarit madhor, së bashku me bashkëshorten, kur ka një të tillë, kur aplikon për ndihmë ekonomike, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar, brenda 10 ditëve të para të muajit, të dhënat e mëposhtme:

a) Formularin për aplikim për ndihmë ekonomike, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi është pjesë përbërëse e tij dhe përmbledh informacionin për:

- i) demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin;
- ii) llojin e banesës;
- iii) pasuritë/asetet familjare;
- iv) të ardhurat nga programet e mbrojtjes shoqërore dhe të ardhurat e tjera.

2. Administratori shoqëror, pasi verifikon situatën socialekonomike të familjeve në nevojë, kur futen për herë të parë në skemë, si dhe dy herë në vit për të gjitha familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar të dhënat sipas formularit në shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Administratori shoqëror, në prani të kryetarit të familjes/anëtarit madhor, së bashku me bashkëshorten, kur ka një të tillë, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar deklaratën, sipas shtojcës 3, që është pjesë përbërëse e vendimit të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe që plotësohet çdo 3 (tre) muaj.

4. Administratorët shoqërorë janë të detyruar që dokumentet e përcaktuara në pikën 4, të kreut I, dhe pikat 1, 2 dhe 3, të kreut II, të këtij vendimi, t'i ruajnë sipas legjislacionit në fuqi për ruajtjen e dokumentacionit.

5. Ndryshimi i vendbanimit të përfituesve të ndihmës ekonomike shoqërohet me transferimin e dokumentacionit pranë bashkisë/njësisë administrative të vendbanimit të ri.

6. Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki përgatit projektvendimin për familjet/individët që kërkojnë të trajtohen me ndihmë ekonomike, në bazë të të dhënave të gjeneruara nga administratori shoqëror dhe e paraqet për miratim pranë këshillit bashkiak, i cili brenda datës 20 të çdo muaji merr vendimin për propozim për familjet/individët përfitues të ndihmës ekonomike dhe ia përcjell Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

7. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas ardhjes së vendimit për propozim nga këshilli bashkiak, verifikon të dhënat e hedhura në Regjistrin Elektronik Kombëtar, konfirmon saktësinë e tyre pranë autoriteteve shtetërore përgjegjëse dhe në bazë të aplikimit të formulës së pikëzuar për familjet në nevojë, gjeneron vendimin për përfitimin e ndihmës ekonomike, përkatësisht:

- a) Për familjet/individët përfitues të ndihmës ekonomike dhe masën e përfitimit të tyre;
- b) Për familjet/individët jopërfitues me arsyen përkatëse të refuzimit.

8. Strukturat e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, mjeku i familjes dhe administratori shoqëror, koordinojnë procesin e dhënies së ndihmës ekonomike, duke bërë të mundur dhënien e informacionit për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë, për personat e grup-moshës 35–70 vjeç. Administratori shoqëror ka detyrimin të njoftojë 3 muaj rresht, para muajit të lindjes, personat e grup-moshës 35–70 vjeç që përfitojnë ndihmë ekonomike për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë, në një nga ditët e muajit të lindjes. Personi i njoftuar është i detyruar të paraqitet në muajin pasardhës të muajit të lindjes me një vërtetim nga qendra shëndetësore që ka kryer kontrollin mjekësor bazë. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, brenda 7 ditëve kalendrike, nëpërmjet strukturave rajonale të tij, dërgon informacionin e nevojshëm pranë administratorit shoqëror.



9. Përfshihen nga përfitimi i ndihmës ekonomike, për një periudhë gjashtë mujore, familjet të cilat kanë në përbërje të tyre edhe një anëtar të vetëm që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) Kryen ndarje të qëllimshme të anëtarëve të familjes, kur nuk krijohet një kurorë e re, me përjashtim të rastit vajzë nënë;

b) Nuk tërheq ndihmën ekonomike, brenda një afati 10-ditor nga dita e depozitimit në llogarinë bankare/kryerjes së pagesave nga Posta Shqiptare, për përfituesit e ndihmës ekonomike me përjashtim të rasteve kur kjo ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme si shëndetësore dhe fatkeqësi;

c) Refuzon verifikimin e situatës social-ekonomike në familje. Refuzimi dokumentohet me procesverbal, sipas shtojcës 4;

ç) Fsheh informacionin apo kryen deklaram të rremë mbi të dhënat e kërkuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi;

d) Nuk deklaron ndryshimet e situatës social-ekonomike në deklaratën e paraqitjes çdo tre muaj të familjes;

dh) Refuzojnë përfshirjen në kurset e formimit profesional ose refuzojnë ofertat e përshtatshme për punë të zyrave të punës, për anëtarët në moshë aktive pune të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nxitjen e punësimit;

e) Anëtarët në moshë aktive pune të aftë për punë, nuk rezultojnë punëkërkues të papunë, apo të vetëpunësuar pranë zyrave të punës.

10. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, i dërgon Kryetarit të Bashkisë vendimin:

a) për të njoftuar kërkuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike;

b) për të kryer veprimet financiare, për kryerjen e pagesës, për përfituesit e ndihmës ekonomike.

11. Pagesat e ndihmës ekonomike, në masën e përcaktuar në kreun III të këtij vendimi, paguhet nga shërbimet bankare ose Posta Shqiptare, pranë bashkive/njërive administrative ku ka vendbanimin përfituesi. Bashkia merr masa që këto pagesa të merren të plota nga përfituesit dhe të mos tarifohen/komisionohen.

12. Njësia administrative, me kërkesë të qytetarit, e pajis atë me dokument që vërteton se trajtohet me ndihmë ekonomike, duke përcaktuar masën e përfitimit dhe periudhën e trajtimit.

13. Këshilli bashkiak ka të drejtë të trajtojë me ndihmë ekonomike familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik të kryer nga administratori shoqëror. Këto familje do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar për bllokndihmën ekonomike deri në 6% dhe/ose me fonde të buxhetit vendor. Mënyra e dhënies së ndihmës ekonomike, për familjet që nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

III. MASA E NDIHMËS EKONOMIKE

1. Përlllogaritja e masës së plotë të ndihmës ekonomike, për familjet e përzgjedhura në bazë të formulës së pikëzimit, bëhet sipas strukturës së familjes, por nuk mund të jetë më e lartë se 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj.

2. Kur në përbërjen e strukturës së familjes, për efekt të llogaritjes së masës së ndihmës ekonomike, mbetet vetëm një anëtar, masa e ndihmës ekonomike për këtë të fundit është ajo e llogaritur për këtë anëtar.

3. Për bashkëshortët në proces zgjidhjeje martese, kur ende nuk ka një vendim gjykatë të formës së prerë, masa e ndihmës ekonomike për secilin bashkëshort, do të jetë e përlllogaritur në bazë të strukturës së familjes, sipas pikës 2, të kreut III, të këtij vendimi.

4. Masa e ndihmës ekonomike, në muaj, për prindërit e fëmijëve të lindur është, si më poshtë:

a) trinjakë 3 000 (tre mijë) lekë, për çdo fëmijë;

b) katërnjakë 4 000 (katër mijë) lekë, për çdo fëmijë;

c) pesënjakë 5 000 (pesë mijë) lekë, për çdo fëmijë.

Kjo ndihmë ekonomike përfitohet deri në mbarimin e arsimit bazë, por jo më shumë se 18 vjeç.

5. Masa e ndihmës ekonomike për viktimat e trafikimit është 3 000 (tre mijë) lekë në muaj. Kjo ndihmë ekonomike përfitohet pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre.



6. Masa e ndihmës ekonomike për çdo viktimë të dhunës në marrëdhëniet familjare, të përcaktuar në urdhrin e mbrojtjes apo urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, është 3 000 (tre mijë) lekë në muaj. Kjo ndihmë ekonomike përfitohet gjatë periudhës së vlefshmërisë të urdhrin të mbrojtjes ose urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, të përcaktuar në vendimin e gjykatës.

7. Masa e ndihmës ekonomike, për çdo jetim, është 3 000 (tre mijë) lekë në muaj. Kjo ndihmë ekonomike përfitohet nga jetimët që nuk janë në institucione deri në çastin e punësimit të tyre.

8. Anëtarët e familjes, fëmijë, për të cilët vërtetohet që ndjekin arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç, marrin një shtesë në masën 300 (treqind) lekë në muaj gjatë vitit shkollor.

9. Anëtarët e familjes, fëmijë, për të cilët vërtetohet se janë vaksinuar sipas kalendarit të vaksinimit, marrin një shtesë në masën 100 (njëqind) lekë, për çdo vaksinë të kryer.

10. Për anëtarin e familjes në nevojë, që është person me aftësi të kufizuara, invalid pune, nuk llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen.

11. Të drejtën për ta tërhequr dhe marrë në dorëzim ndihmën ekonomike për familjet në nevojë e ka bashkëshortja. Për rastet kur në strukturën e familjes bashkëshortja mungon të drejtën e tërheqjes e ka kryetari i familjes.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen të gjitha organet e administratës shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore, të përcaktuara në pikën 1, për zbatimin e këtij vendimi.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet sociale të nxjerrë udhëzimet e nevojshme në zbatim të vendimit.

3. Vendimi nr. 904, datë 12.12.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot”, i ndryshuar, dhe vendimi nr.787, datë 14.12.2005, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, i ndryshuar, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



FORMULAR APLIKIMI PËR NDIHMË EKONOMIKE

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR
MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË



Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Tel: E-mail: Web:	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, ME SHKRONJË TË MADHE E NË NGJYRË BLU.	

SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKANTIN

1. Emri		2. Mbiemri	
3. Emri i Babait		4. NID Nr. i identifikimit personal	
5. Gjinia	☐ Mashkull ☐ Femër	6. Datëlindja	
7. Vendlindja		8. Shtetësia	
9. Adresa			
10. Qyteti		11. Rrethi	
12. Kodi Postar		13. E-mail	
14. Nr. Tel. Celular		15. Nr. Tel. Fiks	

SEKSIONI A2: INFORMACION SPECIFIK MBI ADMINISTRATORIN SOCIAL

1. Emri		2. Mbiemri	
3. NID Nr. i identifikimit personal			

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

1. Grupi etnik:	☐ Shqiptar ☐ Maqedonas ☐ Tjetër (specifiko)	☐ Grek ☐ Malazeze	☐ Rom ☐ Vllahe
2. Gjuha në të cilën do të dëshironi të merrni informacion të mëtejshëm në lidhje me aplikimin tuaj			
3. A përfiton pagesë të aftësisë së kufizuar/pension invaliditeti ndonjë nga anëtarët e familjes?	☐ Po ☐ Jo		
ARSIMI DHE PUNËSIMI			
4. Arsimi më i lartë i arritur:	☐ Asnjë ☐ Arsim fillor 4-vjeçar ☐ Përfundimtar 8/9 vite arsim fillor ☐ Arsim i mesëm i përgjithshëm ☐ Arsim profesional 2-3 vjet		
	☐ Arsim profesional 4-5 vjet ☐ Pasuniversitar në Shqipëri ☐ Përfunduar universitetin në Shqipëri ☐ Përfunduar universitetin jashtë Shqipërisë ☐ Pasuniversitar jashtë Shqipërisë		



PËR TË GJITHË PERSONAT NË FAMILJE QË JANË 16 VJEÇ E LART

Nr	Emër, Mbiemër	A keni punuar në 4 javët e fundit? Përfshirë punën e papaguar në një fermë apo biznes familjar apo edhe disa orë punë si e rastësishme?	Nëse ju nuk keni punuar, a keni pasur një punë nga e cila keni munguar përkohësisht?	Në këtë punë ju: 1 = Një punonjës i dikujt i cili nuk është anëtar i familjes 2 = Punëtor me pagesë në një fermë familjare apo biznes tjetër 3 = Punëdhënës 4 = Punëtor me llogari më vete (i vetë- punësuar 5 = Punëtor i paguar në fermë/biznes familjar 6 = Të tjera ____	A keni të drejtë te perfitoni nga skema e sigurimeve shoqërore në këtë punë?	Sa ishte pagesa juaj e fundit apo fitimet NETO? (Nëse i intervistuari ende nuk është paguar, PYET: Çfarë pagese presin?) Cilën kohorë mbulon kjo pagesë / apo fitim?				
						Lekë	Njësia kohore	Lekë	Njësia kohore	
1										
2										
3										
4										
5										
6										
7										
8										
9										
10										

BANESA, UJË/DRITA/GAZ DHE MALLRA TË QËNDRUESHËM

5. Tipi i banesës:

- ☐ Shtëpi për një familje
☐ Banesa është një ndërtesë me 15 apartamente
☐ Banesa është një ndërtesë me më shumë se 15 apartamente
☐ Të tjera (specifiko) _____

6. Numi i dhomave që ka familja

(përfshijto kuzhinën, ballkonin, korridoret dhe banjat)

7. Gjendja e njësisë së banimit:

- ☐ Gjendje shumë e mirë
☐ E përshtatshme për jetesë
☐ E përshtatshme për jetesë
☐ Në rikonstruktion



8. Lloji i banjës që ka banesa:

- ☐ WC brenda shtëpisë
☐ 2 ose më shumë WC brenda shtëpisë
☐ Të tjera (specifiko)
- ☐ WC jashtë me tubacione
☐ WC jashtë pa tubacion

9. Të tjera:

- ☐ Kuzhinë të ndarë
☐ Dush/vaskë të ndarë
☐ Ballkon ose tarracë
☐ Aneks gatimi
- ☐ Papafingo
☐ Garazh
☐ Ashensor

10. Statusi i pronësisë së ndërtesës:

- ☐ Pronar
☐ Pronar me një hua hipotekore për ndërtesën
☐ E marrë me qira nga një individ privat
☐ E dhënë me qira nga shteti
☐ Jetoj falas/pa pagesë
☐ Të tjera (specifiko)

11. Distanca më e afërt e banesës në minuta nga:

(me këmbë vajtje/ose ardhje)

Stacion Autobusi/
Furgoni

Shkollë fillore

Ambulancë/
doktor

12. Burimi kryesor i ujit në familje:

- ☐ Ujë i rrjedhshëm brenda banesës
☐ Ujë i rrjedhshëm jashtë banesës
☐ Lum, liqen, pellg uxor ose diçka e tillë
☐ Të tjera (specifiko)
- ☐ Autobot me ujë
☐ Burim ose pus
☐ Çezmë publike

13. Burimi i ngrohjes që përdoret në familje:

- ☐ Energji elektrike
☐ Dru zjarri
☐ Gaz
☐ Të tjera (specifiko)
- ☐ Qymyr
☐ Asnjë/jo ngrohje
☐ Ngrrohje qendrore
☐ Naftë/vajguri

14. Matësi i energjisë elektrike:

- ☐ Të përbashkët
☐ Nuk ka matës
- ☐ Individual

15. A përdor familja juaj gaz?

☐ Po ☐ Jo

16. Qëllimi i përdorimit të gazit:

- ☐ Ndriçim
☐ Ngrrohje
- ☐ Gatim
☐ Aparate të tjera elektrike

ASETET FAMILJARE

17. Për çdo artikull të listuar më poshtë, ju lutem tregoni nëse familja juaj i zotëron ato apo jo



Artikulli	Kodi	1=Po, 2=Jo
TV me ngjyra	101	
Tv pa ngjyra	102	
Video/DVD player	103	
Magnetofon/CD player	104	
Kamera/video kamera	105	
Frigorifer	106	
Frigorifer ftohës (ngrirës)	107	
Makinë larëse	108	
Pjatararëse	109	
Sobë me gaz/energji elektrike	110	
Sobë me vajguri	111	
Sobë me dru zjarri	112	
Kalorifer	113	
Gjenerator	114	
Makinë qepëse/thurëse	115	
Kondicioner	116	
Boiler	117	
Komputer	118	
Aparat marrës satelitor/aparat marrës kabllor	119	
Biçikletë	120	
Motoçikletë/ Motor me kubik të vogël	121	
Makinë/veturë	122	
Kamion	123	
Makinë Dumdum	124	
Mikrovalë	125	

18. A zotëron tokë familja juaj?

☐

Po

☐

Jo

19. Nëse po, shëno

sipërfaqen e tokës në m²

20. A ka dikush në familjen tuaj ndonjë gjë të gjallë, shpezë, zgjua bletësh ose që angazhohet në akuakulturë?

☐

Po

☐

Jo

21. Sa kafshë, shpezë, zgjua bletësh, apo peshk te kultivuar ka familja juaj aktualisht?



Tipi	Numri
Lopë	
Derra	
Dele/dhi	
Shpezë	
Kuaj	
Gomar, Mushkë	
Dem	
Zgjuja bletësh	
Lepuj	
Peshk (<i>akuakulturë</i>)	

MBROJTJA SOCIALE

22. Në 12 muajt e fundit, a ka marrë ndonjë anëtar i familjes tuaj ndonjë pagesë nga burimet e mëposhtme?*(Plotëso tabelën më poshtë për të gjitha burimet)*

Burimi	1 = Po; 2=Jo	Shuma e pagesës së fundit të familjes suaj (Lekë)	Numri i muajve që iu referohet kjo pagesë (Muaj)
Ndihma ekonomike			
Pagesa për aftësi e kufizuar			
Pension pleqërie - Urban			
Pension pleqërie -Rural			
Pension suplementar			
Pension invaliditeti - Urban			
Pension invaliditeti- Rural			
Pension për merita të veçanta			
Pension familjar - Urban			
Pension familjar - Rural			
Pagesë papunësie			
Përfitime për veteranë të luftës			
Pagesa për barrë lindje (<i>përfshin pagesat e marra gjatë lejes së lindjes</i>)			
Kujdesi social/ shërbimet për të moshuarit dhe për personat me aftësi të kufizuar			
Pagesa të lejes së sëmundjes (<i>1-6 muaj</i>)			
Të tjera (<i>specifiko</i>)			

TË ARDHURA TË TJERA

23. Në 12 muajt e fundit a keni marrë pagesë nga burimet e mëposhtme (para në dorë apo formë tjetër pagese) ju apo ndonjë anëtar tjetër i familjes tuaj? *(Plotëso tabelën më poshtë për të gjitha burimet)*



Nr	Burimi	1 = Po; 2=Jo	Shuma në total që ka marrë familja juaj në 12 muajt e fundit, përfshirë vlerën e ndonjë dhurate ose pagesë në formë mallrash (Lekë)
1	Përfitime nga mbrojtja sociale (All SP)		
Remitanca/ dërgesa në të holla/ dhurata			
2	Remitanca/ dhurata nga të afërm jashtë shtetit		
3	Dhurata nga të afërm në Shqipëri		
4	Dhurata nga të afërm të tjerë (përfshirë dhurata për një ceremoni)		
5	Dhurata/ asistencë nga institucione		
Të ardhura nga qiratë			
6	Qira nga toka /por jo tokë bujqësore		
7	Qira nga apartamentet/shtëpia		
8	Qira nga dyqani, dyqanet etj		
9	Qira nga makina, kamioni apo automjete të tjera		
Të ardhura nga shitjet e aseteve			
10	Shitje e pronës së patundshme shtëpi, tokë, etj		
11	Shitje e mallrave të qendrueshëm të familjes		
12	Shitje e aseteve të tjera		
Të ardhura të tjera			
13	Nga ndonjë trashëgimi		
14	Fitime nga lotaritë apo bixhozi/kumari		
15	Të ardhura të tjera		
Të ardhura bujqësore			
16	Prodhime bujqësore të shitura /bimë bujqësore		
17	Produkte të shitura bujqësore si mjaltë, pije alkoolike (raki, verë), ushqim të përpunuar, etj		
18	Gjë e gjallë e shitur /shtazore		
19	Nënprodukte shtazore të shitura (vezë, qumësht, djath, lesh, lëkurë bagëtish, etj		
20	Të ardhura në lekë në dorë ose kontribut në natyrë nga kooperativat bujqësore apo shoqata të tilla		

24. Të ardhurat neto mujore në total të familjes

(Shuma në total e të ardhurave të anëtarëve të familjes nga pagat / rrogat, mbrojtja sociale, pensionet, asistencë)

25. Shpenzimet totale mujore të familjes

26. Tjetër

(diçka që aplikanti dëshiron të thotë)

27. Emri i kryefamiljarit/bashkëshortes

që do të administrojë shumën e ndihmës

SEKSIONI C: DOKUMENTACIONI I PARAQITUR

- ☐ Kopje e letërnjoftimit elektronik të aplikantit dhe e anëtarëve të tjerë të familjes që janë posedues të letërnjoftimit
- ☐ Certifikata e lindjes ose dokumente të tjera të fëmijëve që nuk posedojnë letërnjoftim elektronik
- ☐ Certifikata të tjera që lidhen me regjistrin e familjes
- ☐ Dokumente të tjera të nevojshme për të përcaktuar të ardhurat dhe rrethanat/gjendjen familjare

KLAUZOLA DEKLARATIVE

Unë i/e nënshkruari/a _____ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

Nënshkrimi i Aplikantit

Data	Muaji	Viti					



FORMULAR APLIKIMI

VERIFIKIMI I SITUATËS SOCIAL-EKONOMIKE

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR
MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Tel: E-mail: Web:	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, ME SHKRONJË TË MADHE E NË NGJYRË BLU.	

SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKANTIN

1. Emri 	2. Mbiemri
3. Emri i Babait 	4. NID Nr. i identifikimit personal
5. Gjinia ☐ Mashkull ☐ Femër	6. Datëlindja Data Muaji Viti
7. Vendlindja 	8. Shtetësia
9. Adresa 	
10. Qyteti 	11. Rrethi
12. Kodi Postar 	13. E-mail
14. Nr. Tel. Celular 	15. Nr. Tel. Fiks

SEKSIONI A2: INFORMACION SPECIFIK MBI ADMINISTRATORIN SOCIAL

1. Emri 	2. Mbiemri
3. NID Nr. i identifikimit personal 	

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

DEMOGRAFIA E FAMILJES						
Nr.	Emër, Mbiemër	ID	A është i saktë informacioni rreth anëtarëve të familjes?	A është deklaruar saktë paaftësia?	A është deklaruar saktë statusi i të punësuarit?	A është deklaruar saktë arsimimi?
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						



BANESA, UJË/DRITA/GAZ DHE MALLRA TË QËNDRUESHËM

1. Tipi i banesës

2. Numri i dhomave që ka familja

(përjashtoj kuzhinën, ballkonin, korridoret dhe banjat)

3. Cila është gjendja e njësisë së banimit?

4. A ka banesa juaj:

- ☐ Kuzhinë të ndarë
 ☐ Dush/vaskë të ndarë
 ☐ Ballkon ose tarracë
 ☐ Aneks gatimi
- ☐ Papafingo
 ☐ Garazh
 ☐ Ashensor

5. Cili është statusi i pronësisë së kësaj banese?

6. Çfarë burimi ngrohjeje përdorni kryesisht në familje?

7. A ka banesa matësin e vet të energjisë elektrike?

- ☐
- Po
- ☐
- Jo

8. A përdor familja juaj gaz?

- ☐
- Po
- ☐
- Jo

Cili është qëllimi i përdorimit të gazit?

- ☐ Ndriçim
 ☐ Ngrrohje
 ☐ Gatim
 ☐ Aparatë të tjera elektrike

ASETET FAMILJARE

9. Për çdo artikull të listuar më poshtë, ju lutem tregoni nëse familja juaj i zotëron ato apo jo

Artikulli	Kodi	Kontrollo nëse asetet janë raportuar saktë
TV	101	
Frigorifer	106	
Makinë larëse	108	
Pjatararëse	109	
Sobë me gaz/energji elektrike	110	
Sobë me vajguri	111	
Sobë me dru zjarri	112	
Mikrovalë	125	
Kalorifer	113	
Makinë qepëse/thurëse	115	
Boiler	117	
Aparat marrës satelitor/aparat marrës kabllor	119	
Biçikletë	120	
Motoçikletë/motor me kubik të vogël	121	
Autoveturë (specifiko)	122	



10. A ka dikush në familjen tuaj ndonjë gjë të gjallë?

Asete, gjë e gjallë	Sasia/Njësia
☐ Lopë	
☐ Derra	
☐ Dele/dhi	
☐ Shpezë	
☐ Kuaj	
☐ Gomar, Mushkë	
☐ Dem	
☐ Zgjua bletësh	
☐ Lepuj	
☐ Peshk (akuakulturë)	
☐ Tjetër (specifiko)	

11. Përshkrim i shkurtër i nivelit të jetesës së aplikantit

A përputhet niveli i jetesës me të ardhurat/konsumin e deklaruar? Të ardhurat janë deklaruar më pak apo më shumë?

Nënshkrimi i anëtarit
të familjes

Data Muaji Viti

Nënshkrimi i anëtarit
të familjes

Data Muaji Viti

Nënshkrimi i
administratorit social

Data Muaji Viti

Nënshkrimi i
administratorit social

Data Muaji Viti

KLAUZOLA DEKLARATIVE

Unë i/e nënshkruari/a _____ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

Nënshkrimi i Aplikantit

Data Muaji Viti



Shtojca 3

DEKLARATE E PARAQITJES CDO 3-MUAJ TE FAMILJES

Anëtarët madhore të familjes kërkuese për ndihme ekonomike paraqitet nga data 1 deri 15 çdo 3-muaj pranë administratoreve shoqëror në bazë të ligjit Nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar.

Kryefamiljeri _____

Adresa e Banimit _____

PERBERJA DHE GJENDJA E FAMILJEVE

Muaji _____

Nr.	Emri Mbiemri	Datelindja Dite muaj vit	Lidhja me kryefamiljarin	Gjendja aktuale
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				

Emri Mbiemri i personit që do të administroj paratë _____

Shënim: Te kolona Gjendja Aktuale të shkruhet shënimi përkatës për çdo anëtar të familjes. I punësuar, i vetpunësuar, i papunë, pensionist, nxënës, student, fëmijë, ushtar, në spital, jashtë shtetit, në institucione etj.

Keni ndryshim në deklaratën e Gjendjes Ekonomike dhe Sociale të familjeve.

Po _____, JO _____. Në rast se Po _____ shkruani ndryshimet përkatëse

Firmat

Emri Mbiemri

Date _____ u mor ne dorezim nga Administratori Shoqëror

Firma _____



Shtojca 4

PROCES - VERBAL

I mbajtur sot, më datë ____/____/____. Unë i/e nënshkruara _____, me detyrë administrator shoqëror pranë Bashkisë/njesisë administrative _____, kam ardhur në banesën e z./znj. _____, familje përfituese e ndihmës ekonomike për të kryer vizitën në familje.

Në banesë u gjet z./znj. _____ i datëlindjes _____._____. i pajisur me dokument identifikimi _____, anëtar madhor i familjes përfituese të ndihmës ekonomike i/e cili/a refuzoi verifikimin e situatës social-ekonomike të familjes _____, në zbatim të Vendimit nr. _____, datë _____._____. të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike” për arsyet e mëposhtme:

Bashkia/Njësia Administrative

Administratori shoqëror

(Emër Mbiemër Firmë)

Refuzuesi

(Emër Mbiemër Firmë)

**VENDIM****Nr. 956, datë 7.12.2016**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
DHE TË DETAJEVE TË FORMULËS SË
UNIFIKUAR TË PIKËZIMIT PËR
PËRFITIMIN E NDIHMËS
EKONOMIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Formula e unifikuar e pikëzimit përfshin parametra të lidhur në mënyrë empirike me vlerësimin e situatës ekonomike të familjeve, të tilla si: të ardhurat nga programi i mbrojtjes sociale, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia, blegtoria, trashëgimia dhe dhuratat.

2. Treguesit e vlerësimit, pjesë e formulës së unifikuar të pikëzimit, që ndihmojnë në përcaktimin e kriterëve të pranueshmërisë së familjeve për përfitimin e ndihmës ekonomike, përcaktohen sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Përditësimi i formulës së unifikuar të pikëzimit propozohet nga ministria përgjegjëse për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, në varësi të ndryshimeve të nivelit të varfërisë në vend, të publikuar nga INSTAT-i, dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohet Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 dhjetor 2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Shtojca 1**FORMULA E UNIFIKUAR E PIKËZIMIT****Kategoritë e Variablave**

1. Demografia
1.1 Karakteristika të përgjithshme për madhësinë e familjes
1.2 Gjinia
1.3 Fëmijë
1.4 Të moshuar
1.5 Kapitali Njerëzor/Arsimi
2. Burimi i të ardhurave
2.1 Tregu i punës
2.2 Burime të tjera të ardhurash
3. Karakteristikat e banimit
3.1 Lloji i banesës dhe pronësia
3.2 Madhësia e banesës dhe karakteristika të tjera
4. Asete të banesës
4.1 Pajisje kuzhine
4.2 Pajisje elektronike
4.3 Mjete transporti
5. Rajoni



Kategoritë e variablave dhe lista e plotë e variablave

1. Demografia
1.1 Karakteristika të përgjithshme të madhësinë e familjes
Madhësia e familjes
Numri i anëtarëve të familjes në moshë pune
Familje me 4 ose më pak anëtarë (Po/Jo)
1.2 Gjinia
Kryetfamiljare femer (Po/Jo)
Përqindja e grave në familje
1.3 Fëmijë
Numri i fëmijëve në familje
Prezenca e fëmijëve 5 vjeç ose më pak se 5 vjeç në familje (Po/Jo)
Përqindja e fëmijëve në familje
Përqindja e fëmijëve ndaj anëtarëve në moshë pune (raporti i vartësisë)
1.4 Të moshuar
Numri i të moshuarve
Përqindja e të moshuarve në familje
Përqindja e të moshuarve ndaj anëtarëve në moshë pune (raporti i vartësisë)
1.5 Kapitali Njerëzor/Arsimi
Niveli i arsimimit
2. Burimi i të ardhurave
2.1 Tregu i punës
I regjistruar që askush në familje nuk punon
2.2 Burime të tjera të ardhurash
Merr pension pleqërie (Po/Jo)
Merr pension invaliditeti (Po/Jo)
Merr pension familjar (Po/Jo)
3. Karakteristikat e banimit
3.1 Lloji i banesës dhe pronësia
Apartament (Po/Jo)
Zotëron banesën (Po/Jo)
3.2 Madhësia e banesës dhe karakteristika të tjera
Numri i dhomave për person
Tualet brenda shtëpisë
Kuzhinë e ndarë
Garazh
Papafingo
Terracë
Përdor gaz



<u>Ngrohje me elektricitet, gaz ose qymyr</u>
4. Asete të banesës
4.1 Pajisje kuzhine
<u>Makinë larese</u>
<u>Sobë elektrike ose me gaz</u>
<u>Sobë me dru</u>
4.2 Pajisje elektronike
<u>Video/DVD</u>
<u>Kompjuter</u>
<u>Aparat marrës satelitor</u>
<u>Kondicioner</u>
<u>Lavatrice</u>
4.3 Mjetet transporti
<u>Makinë</u>
<u>Motorr</u>
5. Rajoni
<u>Prefektura ku jeton</u>

VENDIM**Nr. 957, datë 7.12.2016**

**PËR PAGESËN E KOSTOS FINANCIARE
TË SISTEMIT TË IDENTIFIKIMIT DHE
TË REGJISTRIMIT TË KAFSHËVE E
FERMAVE BLEGTORALE NGA
FERMERËT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, nenit 7, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kafshët dhe fermat blegtorale identifikohen dhe regjistrohen sipas sistemit kombëtar të identifikimit dhe të regjistrimit (IR), të mbajtur nga autoriteti kompetent, që është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e këtij sistemi.

2. Të gjithë termat e përcaktuar në ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa termat e më poshtëm kuptojnë:

a) “Fermë”, çdo person fizik apo juridik që ka në pronësi kafshët;

Faqe|27710

b) “Bazë materiale për procesin e identifikimit dhe të regjistrimit të kafshëve e fermave blegtorale”, matrikujt për matrikullimin e kafshëve, regjistrat, pasaportat, kartelat dhe formularët për regjistrimin e kafshëve;

c) “Operator privat”, personi fizik ose juridik, i kontraktuar nga autoriteti kompetent, sipas procedurave të prokurimit publik në fuqi, për zbatimin në terren të identifikimit dhe të regjistrimit të kafshëve.

3. Fermerët, për sistemin e identifikimit dhe të regjistrimit të kafshëve e të fermave blegtorale, që lidhet me pagesën e vlerës së bazës materiale për identifikimin dhe regjistrimin e kafshë si dhe me shërbimin e kryer nga operatorët privatë për vendosjen e matrikujve, paguajnë pjesën e koston financiare duke filluar nga data 1 janar e vitit 2017.

4. Fermerët, për shërbimin e ofruar për matrikullimin e kafshëve, kryejnë pagesën e dokumentuar financiarisht drejtpërdrejt tek operatori privat i kontraktuar.

5. Vlerat për pagesat, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, përcaktohen, si më poshtë vijon:

a) Paga për bazën materiale të identifikimit dhe të regjistrimit të kafshëve, që bazohet në koston e çmimit të bazës materiale të realizuar nga ministria, nëpërmjet procedurës së prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi;



b) Pagesa e shërbimit për vendosjen e matrikujve dhe plotësimin e formularit përkatës nga operatori, që bazohet në tarifat e miratuara me udhëzim të ministrit.

6. Pagesa, nga fermerët, për bazën materiale të sistemit të identifikimit dhe të regjistrimit të kafshëve e të fermave blegtorale, e kryer në çastin e matrikullimit të kafshës, sipas pikës 3 të këtij vendimi, depozitohet e dokumentuar financiarisht nga operatori privat, në llogarinë e ministrisë.

7. Pagesa për shërbimin e vendosjes së matrikujve i paguhet, drejtpërdrejt, operatorit privat nga fermeri.

8. Vlerat financiare, të depozituara nga operatori privat i kontraktuar në buxhetin e ministrisë, do të trajtohen si të ardhura jashtë limitit. Administrimi i këtyre të ardhurave bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Bujqësore dhe do të përdoret për blerjen e bazës materiale për sistemin e identifikimit dhe të regjistrimit të kafshëve e të fermave blegtorale, në bazë të procedurave të prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi dhe urdhrit të ministrit.

9. Vendimi nr. 320, datë 19.3.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale”, shfuqizohet.

10. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 194, datë 30.12.2016

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË OST SHA LIDHUR ME
MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN
E TRANSMETIMIT, SHËRBIMET
NDIHMËSE DHE DISBALANCAT**

Në mbështetje të neneve 1; 16 dhe 62, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, VKM nr. 244, datë 30.3.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.12.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike në lidhje me kërkesën e OST sh.a. nr. 701/1 prot., datë 14.10.2016, OST sh.a., për problematikën mbi mbulimin e humbjeve në

rrjetin e transmetimit, sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjitik,

konstatoi se:

- Aktualisht në tregun shqiptar të energjisë elektrike vetëm njësitë gjeneruese të të licencuarit KESH sh.a. mund të shërbejnë për sigurimin e shërbimeve ndihmëse.

- Neni 1 i ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikon se: “Qëllimi i këtij ligji është garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit”;

- MEI, me shkresën nr. 4514/1 prot., datë 3.8.2016, ka dërguar në ERE qëndrimin e saj lidhur me kërkesën e OST sh.a., për lënien të pandryshuar edhe për 6-mujorin e dytë të vitit 2016 të çmimit të energjisë elektrike që OST sh.a. i paguan KESH sh.a. për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit.

- ERE ka kërkuar edhe në vijim opinionin e MEI-t në lidhje me kërkesën e OST sh.a. nr. 701/1 prot, datë 14.10.2016, OST sh.a., për problematikën mbi sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjitik, duke konstatuar të njëjtat rrethana dhe kushte që lidhen me shërbimet ndihmëse dhe sigurimin e humbjeve në sistemin e transmetimit.

- Me vendimin nr.190, datë 22.12.2016, u vendos lënia në fuqi e vendimit nr. 145, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a për vitin 2015”. (Tarifë kjo e cila reflekton sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe humbjeve në rrjetin e sistemit të transmetimit përmes KESH sh.a.)

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. OST sh.a. të lidhë kontratë bilaterale me pjesëtarin e tregut KESH sh.a., për të siguruar shërbimet ndihmëse dhe të balancimit për vitin 2017, sipas marrëveshjes së miratuar me vendimin nr. 79, datë 7.6.2016, “Për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjitik”, midis OST sh.a. dhe KESH sh.a. dhe në përputhje me çmimin e përcaktuar sipas



vendimit të Bordit të ERE-s nr. 141, datë 26.12.2014.

2. Deri në miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike, për të cilën kanë filluar procedurat me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 191, datë 22.12.2016, për qëllime të prokurimit të humbjeve në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, OST sh.a. të sigurojë humbjet nga KESH sh.a. në përputhje me përcaktimet e kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit, miratuar me vendimin nr. 78, datë 7.6.2016, të Bordit të ERE-s.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a. dhe OST sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 195, datë 30.12.2016

MBI SHTYRJEN E AFATIT TË
VENDIMIT TË ERE-s NR. 115, DATË
7.8.2016, “MBI PËRCAKTIMIN E
FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË
FUNDIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
DERI MË 30 QERSHOR 2017”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit nr. 449, datë 15.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike” dhe nenit 8, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.12.2016, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, “Mbi përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 115, datë 7.8.2016, Bordi i ERE-s ka vendosur të përcaktojë përkohësisht OSHEE sh.a. në cilësinë e Furnizuesit të Shërbimit

Universal, për të kryer detyrat e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të Energjisë Elektrike, nga data 1 korrik 2016 deri më 31 dhjetor 2016.

- Me vendimin nr. 449, datë 15.6.2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar “Kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”.

- Referuar pjesës II, të VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016, të Këshillit të Ministrave, ERE përcakton kushtet dhe procedurat për përzgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit sipas VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016. Në përputhje me këtë përcaktim gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017 do të përpunohen kushtet dhe procedurat për përzgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.

- Në pjesën III, të VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016, përcaktohet se deri në përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit sipas këtij vendimi, ERE cakton përkohësisht furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për të kryer detyrat e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.

- Me VKM-në nr. 244, datë 30.3.2016, janë miratuar “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

- Në VKM nr. 244, datë 30.3.2016 është parashikuar se: “Detyrimi i shërbimit publik përfshin ndër të tjerë KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., ku kjo e fundit do të sigurojë blerjen e energjisë elektrike për qëllime të shërbimit universal nga KESH sh.a.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të përcaktuar në pikën 1 të vendimit të ERE-s nr. 115, datë 7.8.2016 deri më 30 qershor 2017.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 52, datë 14.12.2016**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 15, DATË 3.4.2013 “PËR RINOVIM
LICENCE SHA UJËSJELLËS-
KANALIZIME BERAT-KUÇOVË”**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 15, datë 3.4.2013, “Për rinovim licence sh.a Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhet ndryshimi si më poshtë:
 - Drejtues ligjor: z. Refat Harizi;
 - Drejtuesi teknik: z. Lulzim Sino.

**KRYETARI
Ndriçim Shani**

VENDIM**Nr. 53, datë 29.12.2016**

**MBI TARIFAT E UJIT PËR KONSUM
PUBLIK PËR SHOQËRINË
UK ELBASAN (QYTET) SHA**

Në mbështetje të neneve 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, metodologjisë “Për vendosjen e tarifave” Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Të mosmiratojë tarifat për shoqërinë UK Elbasan (qytet) sh.a.
2. Sh.a. UK Elbasan (qytet) duhet të riaplikojë për miratimin e tarifave me një strukturë të re tarifore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ndriçim Shani**

VENDIM**Nr. 54, datë 30.12.2016**

**MBI TARIFAT E UJIT PËR KONSUM
PUBLIK PËR SHOQËRINË
U GRAMSH SHA**

Në mbështetje të neneve 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, metodologjisë “Për vendosjen e tarifave”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë U Gramsh sh.a.:

- a) Tarifë volumetrike për shërbimet:

Furnizim me ujë

Konsumator familjar:	32 lekë/m ³
Konsumator publik:	90 lekë/m ³
Ente private :	90 lekë/m ³

- b) Tarifë fikse

Konsumator familjar:	60 lekë/m ³
Konsumator publik:	180 lekë/m ³
Ente private :	150 lekë/m ³

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2017:

- uji pa të ardhura (humbjet):	27%
- niveli i matjes klient familjarë:	55%
- niveli i matjes klient jofamiljarë:	100%
- kohëzgjatja e furnizimit:	24 orë/ditë
- efienca e energjisë	
- uji i pijshëm	1.8 kwh/m ³
- efienca e stafit:	9.7 p/000/lidhje
- mbulimi me ujë	100%
- norma e arkëtimit	93%
- cilësia e ujit (klor+koliform)	sipas standardeve

3. Pagesa rregullatore vjetore për U Gramsh sh.a. do të jetë 0.8% e të ardhurave të llogaritura.

4. Vendimi i KKRR-së nr. 5, datë 19.1.2011, “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. U Gramsh”, shfuqizohet.

5. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2017 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

**KRYETARI
Ndriçim Shani**

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. 62-2016-5424 (1406), datë 13.12.2016, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetases Vezire Nexhip Gishti, duke caktuar si ditë të zhdukjes së saj datën 1.1.1945, si dhe të caktojë shtetasin Fitim Osmen Gishti, si kujdestar për administrimin e pasurisë së shtetases Vezire Nexhip Gishti.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 196 lekë